



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranimi / Detezuar Primese / Prilato Receive / Delivery | 22. 04 2021 | 1 | viti god year |
| Organ / Objekti Organ / Jednica Org / Unit | Nr Prot Pr Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKRIMSHUK | 1955/2021 | | 115 |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.235/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2194/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.313/2019 të datës 06.06.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Xheladin Kurbaliu", 1/3 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 63 të datës 06.05.2019 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mos konfirmimit të punës provuese dhe Vlerësimit të punës Provuese më datë 23.04.2019 të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.313/2019 e datës 06.06.2019 e parashtruar nga ankuesi e shqyrtuar sipas Aktgjykimit A.nr.2194/2019 të datës 9.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 06.06.2019 ka parashtruar ankesë me Nr. Port:2592/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 63 të datës 06.05.2019 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mos konfirmimit të punës provuese dhe Vlerësimit të punës Provuese më datë 23.04.2019 të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.06.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e

ankuesit tek Sekretariatit i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa më datë 17.06.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.06.2019 me Nr. Prot:2592/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për mos konfirmimin e punës provuese i datës 06.05.2019; Vendimin me Nr. 63 i datës 06.05.2019 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mos konfirmimit të punës provuese; E-mailin e datës 06.05.2019 nga _____ për ankuesin; Formularin për vlerësimin e punës provuese i datës 26.04.2019; E-mailin e datës 02.05.2019 nga Gyltene Sylejmani për ankuesin; E-mailin e datës 01.03.2019 nga ankuesi; Draftimi Rregullores së PAP-it për Pranimin dhe Dërgimin e Shkresave; Shkresën nga _____ E-mailin e datës 18.03.2019, 15.03.2019, 08.03.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 18.03.2019 nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 16.03.2019 nga _____ për ankuesin etj; E-mailin e datës 04.04.2019, 02.04.2019, 21.03.2019, 22.03.2019, 20.03.2019, 19.03.2019, nga ankuesi; E-mailin e datës 15.03.2019 nga _____ E-mailin e datës 19.03.2019 nga _____; E-mailin e datës 18.03.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 18.03.2019 nga _____ E-mailin e datës 14.03.2019 nga ankuesi; Fteë për takim të grupit punës për historikun nga ankuesi; E-mailin e datës 10.04.2019, 08.04.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 08.04.2019 nga _____ E-mailin e datës 08.04.2019 nga _____ E-mailin e datës 08.04.2019 nga _____ E-mailin e datës 16.05.2019, 15.05.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 15.05.2019 nga _____ E-mailin e datës 14.05.2019, 17.05.2019, 10.05.2019 nga ankuesi; Shkresë për planifikim të aktiviteteve 01 korrik-31 dhjetor 2018; Shkresë për detyra për stafin e sekretariatit të PZAP-it i datës 03.01.2019; E-mailin e datës 25.10.2018 nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 25.10.2018, 24.10.2018, 23.10.2018 nga ankuesi E-mailin e datës 25.10.2018, 23.10.2018 nga _____ Akt Emërimi i datës 31.05.2018 i ankuesit; Dëshminë e datës 06.05.2019 për kundërshtim për pranim të akteve nga ankuesi; Njoftim lidhur me mos pranimin e dokumente i datës 06.05.2019; Procesverbal Nr. 01/2019 i datës 23.04.2019 për takimin për vlerësimin e periudhës provuese; E-mailin e datës 07.05.2019 dhe 06.05.2019 nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 07.05.2019 nga ankuesi; Kërkesë për vlerësimin e punës provuese për Drejtorin e DL në SPZAP e datës 05.04.2019; E-mailin e datës 16.04.2019 nga ankuesi dhe _____ për ankuesin; E-mailin e datës 17.07.2018 nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 17.07.2018 nga ankuesi; Certificate për ankuesin 6-7 shkurt 2019, 18-19 prill 2019; E-mailin e datës 04.02.2019 nga _____ E-mailin e datës 27.11.2018 nga ankuesi; E-mailin e datës 22.11.2018 nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 22.11.2018 nga _____ E-mailin e datës 29.11.2018 nga ankuesi; Draft Rregullore Nr. 06/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa; Shënim Zyrtar i datës 25.10.2018; Deklaratë e datës 25.10.2018 nga Simnica, E-mailin e datës 25.10.2018 nga _____ Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa tetor 2018; Procesverbal i punëtorisë së Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Nr. 03/2019 datë 26-27.10.2018; Rregullore Nr. 01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa protokolluar më datë 07.12.2018; Rregullore Nr. 01/2019 për procedurën e shqyrtimit dhe vendosje së ankesave dhe apeleve; Ftesë dhe rendi i

ditës për takimin e PZAP-it i datës 03.04.2019; Procesverbal Nr. 03/2019 i datës 01.03.2019 për takimin e PZAP; Ftesë dhe rendi i ditës për takimin e PZAP-it i datës 03.05.2019; Procesverbal Nr. 04/2019 i takimit të PZAP; Procesverbal Nr. 06/2019 i datës 03.05.2019 i takimit të PZAP; Procesverbal i mbledhjes së PZAP mbajtur nga data 27-31.03.2019; Rregullore Nr. 02/2019 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në SPZAP prill 2019 dhe e datës 06.05.2019; Agjenda e punëtorisë e PZAP; Vendim Anr.01.2017 mos regjistrimi i subjekteve politike; Vendimin Anr.02/2017 mos emërimin e anëtarëve të KKZ-së; Vendim Anr.04/2017 mos regjistrim i subjekteve politike; Vendim Anr.9/2017 tërheqja nga lista e kandidatëve; Vendi Anr.10/2017 largim nga lista e kandidatëve; Vendim Anr.67/2017 dëmtim i posterave në rrugë publike; Vendim Anr.120/2017 nxirje, provokim dhe urrejtje ndaj ekzistimit re shtetit të Republikës së Kosovës; Vendim Anr.196/2017 vëzhguesit kanë përdorur akronimin e SP tjera politike; Vendim Anr.253/2017 vendosja e posterave në rrugë publike; Vendim Anr.259/2017 kërcënim dhe bartja e votuesve me transport; Vendim Anr.264/2017 presion tek votuesit dhe blera e votave; Vendim Anr.266/2017 votim pa u përdorur llampa dhe sprej; Vendim Anr.277/2017 thyerje e heshtjes zgjedhore duke i udhëzuar votuesit të votojnë për kandidatin për kryeministër; Vendim Anr.322/2017 gabim në përshkrimin e votave; Vendim Anr.341/2017 votuesit janë lejuar të votojnë me dokumente të Serbisë; Vendim Anr.358/2017 shpallje e rezultateve preliminare; Vendim Anr.377/2017 shpallja e rezultateve përfundimtare; Vendim Anr.386/2017 shpallja e rezultateve përfundimtare (ndërrimi i pozicionit në listën e kandidatëve); Vendim A.nr. 407/2017 shpallja e rezultateve përfundimtare (ndërrimi i pozicionit në listën e kandidatëve);Vendimi -ZL.anr.01/2017 mos emërimi i anëtarëve të KKZ-së; Vendim ZL.Anr.28/2017 de certifikim i kandidatit nga gara; Vendim ZL.Anr.67/2017 nxitje e urrejtjes; Vendim ZL.Anr.70/2017 vendosje e posterave në hapësira publike; Vendim ZL.Anr.83/2017 mos përfshirje në listën e votuesve jashtë Kosovës; Vendim ZL.Anr.87/2017 pengimi i mbajtjes së tubimit publik; Vendim ZL.Anr.88/2018 përfshirje të fëmijëve në fushatë zgjedhore; Vendim ZL.Anr.142/2017 vendose e njoftimeve të subjekteve politike në hapësira publike; Vendim ZL.A.nr.192/2017 bërija e fushatës në institucione; Vendim ZL.Anr.223/2017 shpifje dhe nxirje në rrjete sociale; Vendim ZL.Anr.252/2017 nxitje, rovokim dhe urrejtje ndaj ekzistimit te shtetit të Kosovës; Vendim ZL.Anr.442/2017 thyerje e heshtës zgjedhore në afërsi të QV-së; Vendim ZL.Anr.743/2017 keqpërdorim i detyrës zyrtare; Vendim ZL.Anr.1086/2017 thyerje e heshtjes zgjedhore duke i udhëzuar votues të votojnë kandidatin e caktuar; Vendim ZL Anr.1102/2017 parregullsi gjatë ditës së votimi dhe shpallje e rezultateve përfundimtare; Vendim ZL Anr.1114/2017 manipulim me listën e votuesve jashtë Kosovës; Vendim ZL Anr.1119/2017 ligjshmëria e kandidaturës për kryetar të komunës; Vendim ZL Anr.1125/2017 parregullsi gjatë ditës së votimit dhe shpallja e rezultateve përfundimtare; Vendim ZL.Anr.1128/2017 votim me kusht i personave të cilët nuk kanë qenë në listën votuese; Vendim ZL.Anr.1142/2017 shpallja përfundimtare e rezultateve-Rivotim; E-mailin e datës 06.12.2018 dhe 13.12.2018 nga ankuesi; Aktgjykimin A.nr.2194/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 22.08.2019 për ankuesin dhe Përgjigjen në ankesë e datës 17.06.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është palejuar, sepse:

Ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 31.05.2018 ka qenë i emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me periudhe provuese 12 muaj, duke filluar nga data 07.06.2018.

Pas takimit të mbajtur mes ankuesit dhe udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë më datë 23.04.2019, Kryesuesi i Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në cilësi të udhëheqësit të drejtpërdrejt më datë 26.04.2019 ka përgatitur Formularin për vlerësimin e punës provuese për ankuesin, ndërsa më datë 06.05.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 63 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mos konfirmimit të punës provuese.

Bazuar në shkresat e lëndës respektivisht e-mailin e datës 06.05.2019, Kolegji ka gjetur se Menaxherja e Personelit në Sekretariatit e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa më datë 06.05.2019 ankuesit i ka përcjell personalisht në formë fizike Njoftimin nr.64 për mos konfirmimin e punës provuese, duke i bashkangjitur edhe Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 26.04.2019 dhe Vendimin Nr.63 të datës 06.05.2019 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mos konfirmimit të punës provuese, e të cilat dokumente ankuesi nuk i ka papranuar, por që në njoftimin në fjalë, me shkrim ka cituar: *"kundërshtoj pranimin e dokumenteve për shkak se nuk më sjellë procesverbali i vlerësimit të punës..."*.

Pas mospranimit të akteve si me lartë, Menaxherja e Personelit në Sekretariatit e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, i ka dërguar ankuesit dokumentacionin në fjalë përmes e-mailit zyrtar, ndërsa të njëjtën ditë ka përgatitur Njoftimin lidhur me mos pranimin e dokumenteve duke theksuar që *"meqenëse Drejtori nuk ka pranuar dokumentet e lartcekura, të njëjtat i kam dërguar përmes e-maili më datë 06.05.2019 në orën 15:45, dhe se konsideroj se këto dokumente janë dorëzuar dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe Rregulloreve të Shërbimit Civil të Kosovës"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me mënyrën e dorëzimit përkatësisht njoftimit të ankuesit me shkresat zyrtare respektivisht Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 26.04.2019 dhe Vendimin Nr. 63 të datës 06.05.2019 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mos konfirmimit të punës provuese, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenin 112 ku është përcaktuar se: 1. *Njoftimi i një akti ose dokumenti të shkruar duhet të bëhet me anë të njoftimit formal, nëse kjo është e përcaktuar me ligj ose në bazë të vendimit të organit publik.* 2. *Njoftimi formal bëhet nëpërmjet postës së certifikuar, dorëzimit personal, dorëzimit nëpërmjet të tretit, shpalljes publike, si dhe nëpërmjet shkarkimit elektronik apo publikimit zyrtar, siç parashihet në këtë Ligj, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se dorëzimin i akteve të kontestuar është në pajtim me dispozita ligjore si me lartë, e në këtë kuptim njoftimi i ankuesit me Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 26.04.2019 dhe Vendimin Nr. 63 të datës 06.05.2019 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mos konfirmimit të punës provuese është bërë më datë 06.05.2019.*

Ne vështrim të nenit 50 paragrafi 1 dhe nenin 81 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Rregullorja Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë, neni 10 paragrafi 1 ka përcaktuar se: *Nëpunësit civilë, të cilët nuk janë konfirmuar për vazhdimin e marrëdhënies së punës, mund të paraqesin ankesë kundër këtij vendimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, në afat prej*

tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit nga Njësia e Personelit". Po ashtu Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Duke u nisur nga fakti se ankuesi është njoftuar formalisht me aktet e kontestuar me datë 06.05.2019, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 06.06.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është parashtruar në ditën e tridhjetenjë (31) respektivisht jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative si dhe nenin 10 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.235/2021

Avdyll BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
 - Kryesuesit të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës;
 - Menaxherit të Personelit të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës;
- dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

